

Raporti i Nismës të Rinjve për të drejtat e njeriut në Serbi dhe Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut në Kroaci mbi fushatën **1.000.000 nënshkrime për KOMRA** 26 prill - 30 qershor 2011

Fushatën për mbledhjen e nënshkrimeve për themelimin e KOMRA e kanë udhëhequr *Zavod Akademija naprednih idej* (Slloveni), *PRONI* dhe *Omladinski resursni centar* (BeH), *Centar za monitoring - CEMI* (Mali i Zi), *Integra* (Kosovë), *Mladinski obrazovni forum - MOF* (Maqedoni), Nisma e të Rinjve për të drejtat e njeriut Serbi dhe Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kroaci të cilat kanë koordinuar aktivitetet e fushatës në nivel rajonal. Në organizimin e fushatës kanë qenë të involvuar dy koordinator rajonal, tetë nacional (në nivel shtetesh) dhe 81 koordinator lokal të cilët kanë ndërlidhur aktivitetet e vullnetarëve në terren.

Fushata ka zgjatur nga 26.04 deri më 30.06.2011. Deri më 05.07.2011 në Bazën e të dhënave të fushatës për mbledhjen e nënshkrimeve janë futur 542.660 nënshkrime për përkrahje themelimit të KOMRA-s. Në të ardhmen derisa qeveritë e shteteve post-jugosllave nuk të marrin vendimin për themelimin e KOMRA-s, mbledhja e nënshkrimeve dhe përkrahjes do të zhvillohet përmes internetit (<http://support.zarekom.org>) dhe ngjarjeve publike të Koalicionit për KOMRA.

Hapja e fushatës

Fushatë është hapur më 26.04.2011 në ora 12:00 në tetë qytete në rajonin e ish-Jugosllavisë (Sarajevë, Banja Llukë, Beograd, Zagreb, Prishtinë, Shkup, Podgoricë dhe Lubjanë). Kanë marrë pjesë qindra të rinj anëtarë/anëtare të Koalicionit për KOMRA dhe miq të Nismës për KOMRA. Nënshkruesi i parë i peticionit për themelimin e KOMRA-s në Sarajevë ishte kryetari i SDA-së Sulejman Tihqi. Përveç tij në hapjen e fushatës në Sarajevë kishte edhe politikanë tjerë nga SDA dhe SDP të cilët me nënshkrimin e tyre përkrahën themelimin e KOMRA-s. Hapja e fushatës në Prishtinë më 26.04.2011 ishte ngjarja mediale e vitit. Ton i kanë dhënë aktivistët e Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut në Kosovë me aksionin e *Shkrirjes Rajonale*. Një aksion të njëjtë, në hapjen e fushatës në Beograd e kanë realizuar edhe aktivistët e Nismës së të Rinjve për të drejtat e njeriut në Serbi. Në lidhje me hapjen e fushatës janë publikuar mbi 70 reportazhe në mediat e shkruara dhe elektronike.

Organizimi i fushatës

Në fushatë kanë marrë pjesë 1.301 vullnetarë, aktivistë të organizatave rinore dhe anëtarët e disa forumeve rinore të partive politike. Ata kanë mbledhur nënshkrime në 219 shtande në qytetet kryesore dhe vendet e mëdha si dhe përmes aksionit *derë më derë*.

Rrjedha e fushatës

Përkrahja Nismës për KOMRA e cila është theksuar gjatë fushatës së mbledhjes së nënshkrimeve nuk korrespondon plotësisht me pritjet e Koalicionit për KOMRA të bazuar në rezultatet e hulumtimit të agjencionit *IPSOS* të realizuar në prill të vitit 2011. Sipas hulumtimit, Nisma për KOMRA kishte përkrahje dukshëm më të lartë në Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe në Federatën e BeH se sa në Kroaci dhe Republikën Serbe - BeH. Gjatë fushatës në Federatën e BeH dhe Serbi janë mbledhur gjithsejtë më pak nënshkrime nga ajo që pritej deri sa në Banja Llukë (BeH - Republika Serbe) janë mbledhur numër shumë i lartë i nënshkrimeve edhe pse nuk pritej që një gjë e tillë të ndodhte.

Në Kosovë organizata e rinjve *INTEGRA* për katër ja mbledhur 100.559 nënshkrime siç është planifikuar bazuar në Planin e fushatës. Numrin më të madh të nënshkrimeve vullnetarët kanë mbledhur gjatë aksionit *derë më derë*. Me fillim të fushatës, Këshilli Koordinues i shoqatave të familjarëve të t

zhdukurve e cila Nismën për KOMRA e konsideron si serbe dhe për këtë arsye nuk e përkrah ka ftuar qytetarët që të mos nënshkruajnë peticionin por nuk ka pasur ndikim tek qytetarët.

Në BeH janë mbledhur 122.473 nënshkrime. Kryesia e shoqatave të familjarëve të luftëtarëve dhe të zhdukurve në Republikën Serbe (BeH) publikisht ka ftuar qytetarët që të mos nënshkruajnë peticionin për themelimin e Nismës për KOMRA me sqarimin se KOMRA është kundër serbëve. Mediat në RS nuk kanë udhëhequr fushatën kundër Nismës për KOMRA si në mars të vitit 2010 kur kanë përkrahur vlerësimin e Branko Todoroviqit nga Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në RS dhe Edin Ramulliqit nga Shoqata e Prijedorit *Izvor* që procesi i KOMRA-s në BeH ka dështuar. P.sh. *Nezavisne novine* në mënyrë profesionale kanë përcjellë informacionin mbi rrjedhën e fushatës. Mbledhja e nënshkrimeve në RS është ndërprerë në kohën e protestave kundër arrestimit të Ratko Mlladiqit. Përveç ekipit të vullnetarëve të mirë të organizuar, përmbajtja e e mediave dhe qeverisë nga kritikant dhe sulmet ndaj disa anëtarëve të Koalicionit për KOMRA gjë që e kanë bërë gjatë marsit të vitit 2010 gjithsesi kanë kontribuar që në Banja Llukë të mbledhen 45.239 nënshkrime. Numri i nënshkrimeve të mbledhura në Federatën e BeH është më i vogël se që është pritur. Përveç përkrahjes së fuqishme të gazetës *Oslobođenja*, asnjë nga mediat tjera të shkruara nuk kanë qenë të interesuar që të përcjellin fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve. Gjatë rrjedhës së fushatës televizioni më i shikuar në Sarajevë FTV ka publikuar dy reportazhe negative mbi Nismën për KOMRA dhe Natasha Kandiçit që përveç numrit jo të kënaqshëm të vullnetarëve ka kontribuar në përkrahjen më të vogël nga ajo që është pritur.

Në Mal të Zi fushata e mbledhjes së nënshkrimeve ka kaluar në shenjë të përkrahjes së fuqishme politike dhe përkrahjes publike nismës për themelimin e KOMRA-s.

Në Serbi fushata është zhvilluar në kontekst të fushatës pozitive mediale, veçanërisht përkrahjes së fuqishme nga ana e RTS-it dhe përkrahjes së partive më të fuqishme në vend. Është vlerësim i përgjithshëm se ka mundur të mbledhen më shumë se 254.539 nënshkrime sa janë mbledhur gjatë fushatës.

Në Maqedoni fushata e mbledhjes së nënshkrimeve për KOMRA ka tejkaluar në shenjë të përkrahjes së inkuadrimin të Maqedonisë në nismat rajonale.

Në Slloveni janë mbledhur 5.000 nënshkrime sa është paraparë me planin e fushatës. Qytetarët nuk kanë treguar interesim për nisma nga shtetet e Ballkanit perëndimor. Në faqet e internetit të diasporës kroate, boshnjake dhe serbe ka pasur ftesë për bojkot të nismës për KOMRA.

Në Kroaci fushata e mbledhjes së nënshkrimeve ka filluar pak kohë pasi që Tribunali i Hagës ka shpallur aktgjykimet dy gjeneralëve të ushtrisë kroate e cila në masë të madhe ka rritur rezistencën ndaj ndërlidhjes rajonale dhe nismave rajonale. Vullnetarët kanë punuar nën trysinë e qytetarëve dhe pa përkrahje të partive politike dhe institucioneve. Në fillim të fushatës, anëtarët e Forumit Rinor të SDP-së kanë marrë pjesë në mbledhjen e nënshkrimeve por Kryesia e kësaj partie ka vendosur që SDP mos të jetë e inkuadruar në fushatën për mbledhjen e nënshkrimeve dhe se nuk i jep përkrahje. Për këtë arsye vullnetarët nga radhët e SDP-së kanë ndërprerë aktivitetin e tyre në fushatë. Shoqata e familjarëve të ndaluarve dhe të zhdukurve të ushtrisë kroate publikisht ka dhënë qëndrimin kundërshtues organizimit të fushatës *Një milion nënshkrime* në Kroaci me arsyetimin se “me kërkimin e nënshkrimit për të vërtetën mbi viktimat do të manipulohet ndjeshmëria e ndërlidhur me gjithë atë që ka ndodhur gjatë luftës atdhetare dhe se do t’i japin nënshkrimin qëllimeve të KOMRA-s me të cilat ata nuk pajtohen “.

Incidentet

Gjatë fushatës janë shënuar disa raste të ofendimit të vullnetarëve për shkak se po promovojnë nismën rajonale dhe ftojnë për bashkëpunim ndërmjet shteteve të cilat e kanë përbërë dikur ish-Jugosllavinë. Në Doboj (BeH) një mashkull i panjohur fizikisht kanë shtyrë shtangin dhe ka ofenduar vullnetarët. Në Dubrovnik (Kroaci) një mashkull i panjohur ka shkelmuar materialet promovuese të cilët kanë qëndruar në shtangin e Koalicionit për KOMRA. Në qendër të Splitit (Kroaci) një mashkull në moshë të mesme ka urinuar mbi vullnetarët e shtandet e Nismës të të rinjve për të drejtat e njeriut ka ka ikur. Gjatë aksionit të përbashkët të të rinjve nga Kroacia, Sllovenia, BeH dhe Serbia më 16.06.2011 në Zagreb, në sheshin Bane Jellaçiq e emërtuar si *Shkrirja rajonale* rreth pesëdhjetë aktivistë për tre orë ka mbledhur 200 nënshkrime për përkrahje. Ka ndodhur që vullnetarëve iu kanë afruar qytetarët dhe i kanë ofenduar pse po promovojnë nismën rajonale në Kroaci.

Përkrahja e politikanëve dhe personaliteteve publike

Në **Kroaci** nënshkrimin e tyre për KOMRA e kanë dhënë nënkryetari i qeverisë së Republikës së Kroacisë Slllobodan Uzellac, kryebashkiakët e Poreçit dhe Karlovocit, Edi Shtifaniqi dhe Damir Jelliq, kryebashkiaku i Vukovarit dhe anëtari i SDP-së Zhelko Sabo, nënkryetari i bashkisë së Shibenikut Franko Vidoviq, nënkryetari i qarkut të Brodsko-Posavske Davor Vllaoviq, deputetët e parlamentit nga rradhët e SDP-së Mirela Holy, Shime Luçin, Ingrid Antiçeviq Marinoviq, Josip Leko, Nenad Staziq dhe Karolina Leaković, deputeti i *Istarsko—demokratskog saveza* (IDS) Damir Kajin, deputeti i pavarur Ratko Gajica, ish-presidenti i Kroacisë Stjepan Mesiq, shkrimtari dhe publicisti Slllobodan Shnajder, dhe shumë të tjerë.

Në Serbi peticionin e kanë nënshkruar kryetari i Kuvendit të Vojvodinës Shandor Egereshi, kryetari i Qeverisë së Vojvodinës Bojan Pajtiq, nënkryetarja e Kuvendit të Republikës së Serbisë Judita Popoviq, deputetët e LDP-së, deputetja e LSV-së Aleksandra Jerkov dhe SDU-së Zharko Koraq, kryetari i komunës së Bujanovcit, Shaip Kamberi, Kryetarja i Komunës së Pançevës Vesna Martinović, kryetari i komunës së Valevës, Zoran Jakovljević, kryetari i Komunës së Somborit Nemanja Deliq dhe kryetari i Komunës së Suboticës Saša Vučinić, pastaj kryetari i Partisë Liberal-Demokratike Çedomir Jovanoviq, kryetari i Ligës së Socialdemokratëve të Vojvodinës Nenad Çanak, kryetari i Partisë për Veprim Demokratik Riza Halimi, nënkryetarja e Partisë Demokratike Jelena Trivan, kryetari i Unionit të Rajoneve të Serbisë Mllagjan Dinkiq, kryetari i Lëvizjes Serbe të Ripërtrirjes Vuk Drashkoviq, sekretari shtetëror për informatat e rëndësisë publike Rodoljub Shabiq, sekretari shtetëror në Ministrinë për Kosovë dhe Metohi Oliver Ivanoviq, dhe të tjerë.

Në **Mal të Zi**, kryeministri i Qeverisë së Malit të Zi Igor llukshiq më 29.04.2011 ka nënshkruar peticionin gjatë takimit me anëtarët e koalicionit për KOMRA. Gjatë fushatës, shumë deputetë, liderë partish politike dhe personalitete publike kanë dhënë nënshkrimin e tyre për themelimin e KOMRA-s.

Në **Slloveni** nënshkrimin për themelimin e KOMRA-s ka dhënë Ombduspersoni Zdenka Čebašek – Travnik më 3.05. 2011 dhe nënkryetari i Forumit Rinor të Partisë Liberal Demokratike të Sllovenisë Borut Cink.

Në ditën e hapjes së fushatës për mbledhjen e nënshkrimeve në **Bosnje dhe Hercegovinë** më 26.04.2011 nënshkrimin e përkrahjes për themelimin e KOMRA-s e kanë dhënë nënkryetari i Federatës së BeH Mirsad Kebo, kryetari i SDA-së Sulejman Tihiq, kryebashkiaku i Sarajevës Allija Behmen, Ministri i Kulturës Sallmir Kapllan dhe përfaqësuesja e SDP-së në parlamentin e FBeH-së Besima Boriq, shkrimtari, eseisti, analisti dhe publicisti Ivan Lovrenoviq, regjisori Dino MUsafiq dhe Danis Tanoviq. Nënshkrimin e përkrahjes e kanë dhënë kryetari e nënkryetari i Federatës së BeH Zhivko Budimir dhe Svetozar Pudariq,

ministri i sigurisë së BeH Sadik Ahmetoviq, kryesuesi i Këshillit i Komunës Qendra e Sarajevës Sllaven Kovaçeviq, kryetari i komunës Velika Kladuša, Bosanska Krupa, Doboj, Bihaq dhe Cazin Admil Mulaliq, Armin Halitoviq, Obren Petrovici, Albin Musliq dhe Nermin Ogreshviciqë, kryetari dhe nënkryetari i Partisë Popullore Demokratike të BeH Rifet Doliq dhe Kenan Keseroviq, kryetari i *Naše stranke* Dennis Gratz, nënkryetari i HDZ 1990 Martin Raguzh, Forumi i të Rinjve të të SDP-së BeH Lidija Koraq, shkrimtarja dhe poetja Ferida Durakoviq, aktori Ermin Bravo, regjisori Haris Pashoviq, dhe të tjerë.

Nënshkrimin e përkrahjes e ka dhënë edhe anëtarë i Kryesisë së Bosnje dhe Hercegovinës Zhelko Komshiq, gjatë dorëzimit të Propozim Statutit të KOMRA-s dhe nënshkrimeve të mbledhura për përkrahje themelimit të KOMRA-s më 23 qershor 2011.

Në **Kosovë** Rada Trajkoviq udhëheqësja e listës Unike Serbe ka nënshkruar petitionin për themelimin e KOMRA-s më 16.05.2011. Në takim me anëtarët e Koalicionit për KOMRA më 07.06.2011 Ministri i Shëndetësisë së Kosovës Ferid Agani me nënshkrimin për KOMRA ka përkrahur themelimin e komisionit rajonal.

Në **Maqedoni** nënshkrimin e përkrahjes për themelimin e KOMRA-s më 20.06.2011 ka dhënë deputeti i parlamentit nga radhët e partisë në qeveri VMRO DPMNE Vlatko Gojcev.

Statistika

Me datë 5.07.2011.

Serbi	
Beograd	63910
Novi Sad	34446
Suboticë	3808
Zrenjanin	799
Pançevo	2939
Sombor	4613
Kikindë	3340
Sremska Mitrovicë	2793
Kragujevc	10613
Çaçak	5867
Krlevë	6420
Krushevc	5036
Jagodinë	731
Smederevë	2660
Pozharevc	1037
Valevë	8691
Novi Pazar	13593
Tutin/Sjenicë	7358
Priboj	3638
Prijepolje	4736
Nish	24943
Leskovc	8300

Vranje	5380
Zaječar	2683
Dimitrovgrad/Bosilegrad	2833
Shabac	5282
Preshevë	5380
Bujanovc	5200
Uzhice	3520
Online	2490
Total (Serbi)	254539
Bosnje dhe Hercegovinë	
Sarajevë	24727
Tuzëll	6882
Kalesija	2325
Zhivinice	2809
Banoviqi	2342
Llukavac	1794
Bihaq	2808
Cazin	1950
Velika Kladushë	2533
Bosanska Krupa	1425
Sanski Most	2678
Zenicë	1758
Stolac	480
Celic	465
Kladanj	51
Olovo/ Teocik/Sapna	62
Bosanski Petrovac	60
Drvar/Jajce	69
Gornji/Donji Vakuf	41
Varesht/Kakanj	70
Modrica	78
Domalevac	47
Zavidoviqi	1653
Travnik	2397
Magllaj	672
Teshanj	396
Gradaçac	2695
Srebrenik	1507
Orashje	2529

Oxhak	478
Jabllanicë	1895
Konjic	1011
Mostar	1713
Banja Llukë	45239
Bijelinë/Uglevik	1792
Brčko	752
Doboj	408
Vllasenicë (Bratunac/Srebrenica)	931
Online	954
Total	122473
Kroaci	
Zagreb	7123
Split	2035
Osijek	4304
Varazhdin	1499
Pula	666
Sllavonski Brod/Pozhega	930
Zadar	196
Velika Gorica	109
Karlovac	283
Vukovar	353
Shibenik	722
Sisak	126
Dubrovnik	68
Rovinj/Pazin	657
Online	867
Total	19668
Kosovë	
Prishtinë	18200
Podujevë	5006
Lipjan	700
Kastriot	1400
Fushë Kosovë	1400
Prizren	10500
Suharekë	700
Dragash	700
Malishevë	700

Pejë	12600
Istog	2800
Junik	700
Klinë	1400
Gjakovë	12600
Deçan	1400
Mitrovicë	9800
Skënderaj	2100
Vushtrri	6300
Leposaviç	700
Ferizaj	1400
Shtërpce	700
Shtime	1400
Gjilan	5600
Bujanovc	700
Online	499
Total	100559
Slloveni	
Lubjanë	1499
Novo Mesto	1250
Celje	950
Piran	768
Maribor	689
Online	186
Total	5342
Maqedoni	
Shkup	3271
Tetovë	2693
Shtip	1597
Strugë	1133
Bitola	852
Veteranët NGO	92
Online	384
Total	10022
Mali i Zi	
Podgoricë	9020
Pljevlje	700

Herceg Novi	500
Rozhaje	4000
Bijello Pole	3000
Berane	1800
Tivat	600
Kotor	800
Nikshiqi	3000
Budvë	1040
Bar	200
Ulqin	2500
Tuz	400
Cetinje	750
Kotor	350
Sutomore	400
Online	453
Total	30057
TOTAL	542660